

1. Mother Theresa Association
2. Center for Peace and Tolerance
3. Center for Policies and Advocacy
4. Syri i Vizionit
5. ATTA
6. Kosova Democratic Institute
7. KCIC
8. FOL Movement
9. Mundesia
10. ACTIV

BULETINI TREMUJOR

Nr. 3, DHJETOR 2013 - SHKURT 2014



RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE LOKALE PËR KRYETAR KOMUNASH

1 DHJETOR 2013 – DnV ka monitoruar procesin zgjedhor në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale për kryetar komunash, në të gjitha ato komuna ku po organizohet procesi i balotazhit. Ngjashëm si më 3 nëntor, DnV për monitorimin e këtij procesi ka të angazhuar në terren 1600 vëzhgues si dhe disa ekipe mobile. Ka pasur disa parregullsi si një fotografim i votës, ka pasur prezencë të materialit propagandues të subjekteve politike si dhe në disa vendvotime ka pasur probleme me lista të votuesve, qoftë me prezencën e personave të vdekur në lista, qoftë me vështirësitë e qytetarëve për ta gjetur emrin në listat e votuesve.

PARREGULLSITË NË PROCESIN E VOTIMIT

1 DHJETOR 2013 – DnV ka vazhduar të monitorojë raundin e dytë të procesit zgjedhor për kryetar komunash në të gjitha ato komuna ku është organizuar procesi i balotazhit. Sipas DnV deri në orën 12 dalja e qytetarëve në votime ishte rreth 13%.

Ndër incidentet e raportuara janë:

Mitrovicë –Përleshje fizike brenda vendvotimit në qendrën 1116b/01.

Gjakovë - Në shkollën "Yll Morina", qendra 0202x /07, Menaxheri i qendrës së votimit ka votuar pa dokument identifikimi përkatës.

Ferizaj - Në fshatin Varosh, dyshohet që një automjet civil ka poseduar brenda tij një kuti votimi.

Ka pasur edhe parregullsi të tjera si tentimi për të votuar në emër të dikujt tjetër, tentim për të votuar me shume se një here dhe tentim për të votuar me dokumente identifikimi false.



BULETINI TREMUJOR

Nr. 3, DHJETOR - SHKURT 2013/2014

TAKIME PËR PËRFSHIRJEN E GRAVE NË QEVERINË LOKALE

13 DHJETOR 2013 – DnV ka organizuar takime dhe debate në Suharekë, Podujevë, Rahovec dhe Prizren me temën “ Gruaja në ekzekutiv, sfidë apo realitet pas zgjedhjeve lokale 2013”. Këto tryeza diskutimi u fokusuan në mundësitë e përfaqësimit të gruas në ekzekutiv. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar se me gjithë pjesëmarrjen e grave në zgjedhje dhe kandidimin e tyre për asamblistë, ende mungon vullneti dhe gatishmëria për të ju qasur pozitave vendimmarrëse.



NUK KA ZGJEDHJE TË LIRA PA QELIME TË MIRA

13 SHKURT 2014 - DnV ka prezantuar raportin e vëzhgimit të zgjedhjeve lokale 2013 me titull “Nuk ka zgjedhje të lira pa qëllime të mira”. Ismet Kryeziu udhëheqës i koalicionit të OJQ-ve Demokracia ne Veprim, ka vlerësuar se administrimi i zgjedhjeve lokale 2013, ka qenë shumë më i mirë se sa zgjedhjet e kaluara. Megjithatë ai përmendi disa nga parregullsi të cilat e kanë përcjellur edhe procesin e fundit elektoral si listat e pa pastruara të votuesve, numri i madh i votave të pa vlefshme dhe rastet e shpeshta të votimit familjar. Në këtë tryezë debatuan edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të cilët vlerësuan edhe rolin e gruas në procesin e fundit zgjedhor, duke ju referuar zgjedhjes së zj. Mimoza Kusari-Lila kryetare e Gjakovës. Igballe Rogova përfaqësuese e rrjetit të grave, tha se më në fund po shohim një demokraci që po vjen në Kosovë.

PËRFSHIRJA E GRAVE NË EKZEKUTIV

19 DHJETOR 2013 - DnV ka organizuar një debat me temën: “Pushteti lokal dhe bilanci gjinor në ekzekutiv”, me kryetarë të rinj të disa komunave dhe me përfaqësues të shoqërisë civile, subjekteve politike dhe medie. Aty janë paraqitur disa nga të gjeturat në raport me bilancin gjinor në komunat e Kosovës. Pjesëmarrësit tjerë e kanë theksuar se përfaqësimi i grave në institucionet lokale vazhdon të mbetet vetëm në suaza të kuotës së 30 përqindëshit, pa pasur rol aktiv në ekzekutiv. Për më shumë, diskutimet në debat kanë prekur edhe funksionim e forumit të grave, respektimin e ligjit për barazi gjinore në komuna, e pse jo edhe synim për ta bërë kuotën 50% sepse e tillë është përqindja e grave në popullsi, si dhe përfaqësim më respektues i grave nga ana e medie.



DnV në media:

- Ismet Kryeziu, Udhëheqës i DnV, ka diskutuar për zgjedhjet lokale në emisionin Info Magazine, Klan Kosova;
- Përfaqësues të DnV-së kanë qenë të cituar në një numër të madh të artikujve të mediave të shkruar dhe storie televizive